



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:070903

Datë: 14.10.2020

Numri i dokumentit: 01188138

PKR.nr.78/20

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues Islam Thaçi, me zyrtaren ligjore Zahide Rexhepi, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të pandehurit, J. M, për shkak të veprës penale , dhënja e rryshfetit nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK-së, të cilin e ka mbrojtur av. Tefik Dushica, me autorizimt, sipas aktkuzës së Prokurorisë Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PP.I.nr.69/ 20, të datës 30.06.2009, të cilin e përfaqëson prokurori i shtetit Isuf Sadiku, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, më 30.09.2020, shpalli publikisht, ndërsa më 13.10.2020, hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri J. M, nga babai L. dhe nëna L1. , e lindur C., i lindur më dat... K. Ranillug, me , ka të kryer shkollën e mesme, drejtimi automekanik, i martuar, babë i dy fëmijëve,i punësuar, shofer i kamionit, i gjenjdes së varfër ekonomike, serb, shtetas i Republikës së Kosovës, dhe R, së Sërbisë.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më 28.05.2020, rreth orës, 22, 30 minuta, në pikën kufitare “ Dheu i Bardhë”, në hyrje të Republikës së Kosovës, i pandehuri duke e drejtuar kamionin e markës “Volvo”, me tab.Ab..., ndalet për t’i kryer procedurat e kalimit të kufirit nga zyrtarët policor dhe doganor, dhe gjatë kontrollës së përbashkët të zyrtarit policor dhe doganor, të njëjtit gjejnë mall komercial të fshehur , të pa deklaruar (produkte dhe kozmetikë dhe të tekstilit) në kabinën e kamionit dhe më pas i pandehuri i ofron 20 € dhe duke i thënë zyrtarëve të lartpërmedhur “mos e bini të madhe këtë punë dhe së bashku merrni 20 € dhe pini diçka,”hani”, pastaj zyrtari policor i fotografon parat dhe i konfiskohen.

Me çka ka kryer veprën penale, dhënja e rryshfetit nga neni 422 parag.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitën e sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 44, 69, 70, 71, dhe 72 të KPRK-ës, si dhe nenit 233 dhe 365 të KPPRK-së, të pandehurin, e

G J Y K O N

Më dënim me gjobë në shumën prej 500€ (pesëqind) Euro, dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit, i zëvendësohet në dënim me gjobë, në shumën prej 1000€ (njëmijë) Euro, ashtu që i pandehuri detyrohet që ta paguaj shumën e përgjithshme të dënimit me gjobë , në shumën prej 1.500€ (njëmijë e pesëqind) Euro, në afat prej tre muajve, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit pagesa e dënimit me gjobë, i lejohet që ta bëjë, në tre këste barabarta mujore, duke përpjestuar shumën si më lartë, edhe ate brenda javës së parë të muajëve në vijim.

Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin me gjobë si më lartë, atëher të njëjtit gjykata, dënimin me gjobë do t' ia zëvendësoj në dënim me burgim, duke ia llogaritur 20 euro të dënimit me gjobë, me një ditë burgim.

Detyrohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjygjësor në shumën prej 20 € si dhe shumën prej 50€, në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

Të pandehurit i konfiskohet monedha (para letre) prej 20€ (njëzet) Euro ,e cila duhet të shkatrohet- asgjësohet, konform dispozitave të ligjit në fuqi.

Njoftohet i akuzuari se për çdo ndërrim eventual të adresës së banimit, detyrohet që t'a njoftoj gjykatën deri në përfundimin e procedurës penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzën PP.I.nr.69/ 2020, të datës 18.09.2020, kundër të pandehurit J. M, për shkak të veprës penale dhënja e ryshfetit nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK-së, të cilin e ka mbrojtur av. Tefik Dushica me autorizim.

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda më dt.21.09.2020, ka paraqitur marrëveshjen për pranim të fajësisë, të nënshkruar nga prokurori i shtetit Isuf Sadiku, i pandehuri J. M si dhe mbrojtësi i tij, av. Tefik Dushica.

Gjykata me datë 30.09.2020, ka mbajtur seancën fillestare në të cilën kanë prezentuar prokurori i shtetit Isuf Sadiku, i pandehuri J. M me mbrojtësin e tij, av. Tefik Dushica, sipas autorizimit.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se kemi pranuar kërkesën për fillimin e negociimit për pranimin e fajësisë më datë 18.09.2020, pastaj prokurori i çështjes ka marrë autorizim nga Kryeprokurori i Prokurorisë së Shtetit të PTHDKR në Gjilan, Jetish Maloku dhe kemi filluar të

negociojmë me të pandehurin e sipërtheksuar si dhe mbrojtësen e tij, kështu që është arritur marrëveshja për pranimin e fajësisë me të pandehurin e lartëcekur dhe mbrojtësin e tij.

Prandaj mbes në tërësi pranë marrëveshjes për pranim të fajësisë ngase janë plotësuar kushtet ligjore në pajtim me nenin 233 të Kodit të Procedurës Penale, duke pasur parasysh edhe caktimin e dënimit , i cili dënim është paraparë në marrëveshje.

Mbrojtësi i të pandehurit J. M, av.Tefik Dushica, ka deklaruar se në tërësi e mbështes fjalën e prokurorit të shtetit nga fakti se në prani të organit të akuzës, gjegjësisht prokurorit të çështjes, jemi dakorduar lidhur me pranimin e fajësisë në mes të pandehurit J. M, në njërën anë të cilin e kam mbrojtur unë, dhe prokurorit të çështjes në anën tjetër, e që marrëveshjen e tillë pas konsultimeve me të mbrojturin tim, jemi dakorduar që të njëjtën si të tillë ta nënshkruajmë, duke e njoftuar parapakisht për pasojat dhe benifitet e marrëveshjes.

I pandehuri J. M ka deklaruar: në tërësi e mbështes deklaratën e mbrojtësit tim nga fakti se edhe unë jam dakorduar për marrëveshjen e arritur të cilën edhe e kam nënshkruar.

Pas dëgjimit të deklaratave të palëve, e në mbështetje të nenit 233 paragrafi 21, lidhur me nenin 18 të KPPRK-së, Kryetari i trupit gjykues konstatoi se janë plotësuar kushtet e parapara me ligj, andaj vendosi që të pranohet marrëveshja për pranim të fajësisë , lidhur mes PTHDKR, në njërën anë, dhe të pandehurit J. M me mbrojtësin e tij, në anën tjetër për kryerjen e veprës penale, dhënja e ryshfetit nga neni 422 parag 1 e lidhur me par.28 të KPRK-së.

Gjykata pas dëgjimit të palëve dhe duke vepruar në bazë të nenit 233 paragrafi 21, të KPPRK-së, vendosi që data e sotme, të jetë data kur palët t'i japin deklaratat e tyre në lidhje me dënimin.

Prokurori i shtetit Isuf Sadiku ka deklaruar: i propozoj gjykatës që marrëveshjen e dorëzuar në gjykatë, ta aprovoj si të tillë, duke e pasur parasysh edhe marrëveshjen lidhur me caktimin e dënimit.

Mbrojtësi i të pandehurit J. M, av. Tefik Dushica, ka deklaruar: mbetem në tërësi pranë propozimit të lartëcekur, që gjykata të pandehurit t'ia shqipton dënimin e rekomanduar me marrëveshje, dhe atë duke konsideruar se një dënim i tillë është i mjaftuar për të arritur qëllimin e dënimit. Gjithashtu i ka propozuar gjykatës që të mbrojturit të tij, t'i mundësohet pagesa e dënimit me këste mujore nga fakti se i njëjti nuk është në gjendje të mirë ekonomike dhe nuk ka mundësi ta paguaj përnjëherë dënimin.

I pandehuri J. M, ka deklaruar: në tërësi e mbështes fjalën e mbrojtësit tim, pendohem për veprën e kryer, i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të këtilla apo të ngjashme penale.

Pas pranimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës me numër dhe datë të shënuar si më lartë, si dhe deklaratave të palëve lidhur me dënimin, gjykata të pandehurin, e shpalli fajtor dhe në pajtim me nenin 233 paragrafi 21 i shqiptoi dënimin me gjobë, si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me dënimin e shqiptuar për të pandehurin, gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit, ashtu që të njëjtin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra të tjera penale dhe se ky dënim do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë, që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Për shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag. 1, në lidhje me nenin 450 paragrafi 1 nënparagrafi 2.6 të KPPK-së, duke e detyruar të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20€ si dhe shumën prej 50€ , në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

Të pandehurit J. M, konform nenit 115 paragrafi 2, nënparagrafi 2.3 të KPPRK-së, i konfiskohet monedha (para letre) prej 20€ (njëzet) Euro, e cila duhet të shkatërrohet- asgjësohet, konform dispozitave të ligjit në fuqi.

Me sa u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.78/2020, më 13.10.2020

Zyrtare ligjore
Zahide Rexhepi

Kryetari i trupit gjykues
Islam Thaçi

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.